

**PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË MBLEDHJES  
KËSHILLI I INVESTIMEVE (KI)  
MBLEDHJA XXXII**

**“Konsultimi i reformave strukturore të Programit të Reformave Ekonomike 2024-2026”**

**Tiranë, 15 dhjetor 2023, 10:00 – 11:30**

Mbledhja u drejtua nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, z. Ervin Mete, Kryetar i KI. Në mbledhje morën pjesë 15 anëtarë të KI dhe rreth 30 vëzhgues – përfaqësues të shoqatave të biznesit vendas dhe të huaj dhe institucioneve shtetërore në Shqipëri.

**Hapja e Mbledhjes nga Ministri Ervin Mete, Kryetar i KI**

Në fjalën e tij hyrëse, Ministri Mete theksoi rëndësinë e Programit të Reformave Ekonomike, nisur edhe nga fakti se Komisioni Evropian (KE) publikoi pak javë më parë Planin e Rritjes për vendet e Ballkanit Perëndimor, i cili parashikon 6 miliardë euro fonde për 3 vitet e ardhshme. Nga këto fonde, Shqipëria pritet të përfitojë rreth 1 miliardë euro, në varësi të progresit dhe avancimit të reformave. Në këtë kuadër, Ministri tha se përfshirja sa më e gjerë e komunitetit të biznesit në formësimin e këtyre reformave do të krijojë baza më të qëndrueshme për arritjen e objektivave.

Nga ana tjetër, Ministri informoi se synohet zgjerimi i mëtejshëm i anëtarëve të Këshillit të Investimeve me përfaqësim sa më të gjerë nga komuniteti i biznesit, si një forum i rëndësishëm në dialogun dhe bashkëpunimin Qeveri-Biznes.

**Prezantimi i ERP**

**Z. Endrit Yzeiraj, Zv/Ministër i Financave dhe Ekonomisë**, prezantoi shkurtimisht shtyllat kryesore të draftit të ERP-së për 2024-2026, të përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Pasi dakortësohet, dokumenti i ERP shërben si udhërrëfyes për qeverinë për priorizimin dhe zbatimin e reformave të nevojshme ekonomike. ERP 2024-2026 prezanton përditësime në tre grupime tematike, duke u fokusuar në kapitalin njerëzor, qëndrueshmërinë & rimëkëmbjen dhe konkurrueshmërinë. Reformat strukturore të propozuara mbulojnë arsimin, mbrojtjen sociale, energjinë e rinovueshme, transformimin digjital dhe përmirësimin e klimës së biznesit. Dokumenti luan një rol të rëndësishëm në Planin e Ri të Rritjes të Komisionit Evropian, i cili paraqitet një fond prej 6 miliardë EUR për Ballkanin Perëndimor. ERP fokusohet në fusha kyçe si promovimi i energjisë së rinovueshme, infrastrukturës digjitale dhe transportit të qëndrueshëm. Dokumenti trajton integrimin ekonomik, kërkimin dhe inovacionin, luftën kundër informalitetit dhe mbështetjen e bizneseve inovatore startup. Masat përfshijnë përmirësimin e aksesit në shërbimet elektronike, rritjen e aftësive digjitale dhe zhvillimin e një kuadri ligjor për bizneset startup. Afati kohor për dorëzimin e ERP-së pranë KE është 15 janar 2024.

**Përmbledhje e diskutimeve kryesore**

**Z. Hubert Perr, Delegacioni i BE-së**, theksoi rëndësinë e dokumentit të ERP në kuadër të partneritetit midis Shqipërisë dhe Komisionit Evropian. Ai informoi mbi Mekanizmin për Reformë dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor të Komisionit Evropian, i cili i alokon Shqipërisë rreth 1 miliardë euro për katër vitet e ardhshme, ku një e treta në formën e granteve dhe dy të tretat në kredi me koncesion. Alokimi i fondeve do të lidhet me reforma të prekshme,

ku gjysma do të kalojë përmes mbështetjes buxhetore dhe gjysma tjetër do të jepet për projekte specifike investimi sipas Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor. Më tej, z. Perr ngriti dy çështje që kishin të bënin me procesin dhe përmbajtjen:

1. Në lidhje me procesin. Ai theksoi natyrën transformuese të temave dhe reformave të paraqitura në ERP. Sipas tij, reformat nevojiten të jenë hartohen edhe me përfshirjen e sektorit privat duke u siguruar që ata të kenë një platformë për të shprehur shqetësimet e tyre, si kjo e Këshillit të Investimeve. Përfshirja në këto procese do të paraqesë mundësi për sektorin privat, veçanërisht në drejtim të aksesit të drejtpërdrejtë në tregun e përbashkët dhe integritimit në tregun rajonal.
2. Në lidhje me përmbajtjen. Z. Perr nënvizoi negociatat e vazhdueshme në fushat e reformës në kuadër të Mekanizmit për Reformë dhe Rritje Ekonomike, duke theksuar rëndësinë e përafrimit të prioritetëve me ERP-në. Ky përafrim është thelbësor për të shmangur mesazhet kontradiktore dhe për të siguruar një qasje kohezive. Ndërsa ERP mund të ketë nuanca specifike, veçanërisht në frontin social, ka mbivendosje të konsiderueshme. Ai sugjeroi përdorimin e ERP-së si një dokument bazë për t'u integruar në Mekanizmin për Reformë dhe Rritje Ekonomike. Më tej, ai sqaroi se ERP-ja nuk përfshin aspekte financiare, ndërsa disbursimi i Mekanizmit për Reformë dhe Rritje Ekonomike varet nga zbatimi dhe realizimi i reformave.

Ministri Ervin Mete, MFE, u shpreh se diskutimet mbi reformat në planin e rritjes vazhdojnë, dhe synohet të miratohen brenda mars-prillit të vitit të ardhshëm. Kjo mbledhje mbahet në kohën e duhur, pasi dokumentet janë ende në fazën e diskutimit, dhe kontributi i pjesëmarrësve është i rëndësishëm për të hartuar një plan reformash sa më efektiv dhe në përputhje me nevojat e biznesit. Konsultimi do të shoqërojë gjithë këtë proces, por është thelbësore të kuptohet se reformat që do të ndërmarim kanë rëndësi për të gjithë vendin, veçanërisht për përmirësimin e klimës së biznesit. Këto reformat do të çojnë drejt zhvillimit, dhe është thelbësore që ato, pas miratimit, të gëzojnë mbështetje financiare, duke përfshirë edhe atë nga Bashkimi Evropian.

Znj. Natasha Ahmetaj, Banka e Shqipërisë, theksoi se ERP ka shumë ngjashmëri me “semestrin evropian” dhe paraqet një sfidë të rëndësishme për vendet anëtare. Ajo vlerësoi se ky proces është një mjet i rëndësishëm që përgatit vendin për sfidat e ardhshme. Znj. Ahmetaj përmendi se ERP ka një set politikash të ngjashme me ato të BE-së, duke përfshirë reformat strukturore dhe planet e stabilizimit. Ajo vlerësoi se fokusi në përmirësimin e kapitalit human dhe digjitalizimin është i rëndësishëm për integrimin në ekonominë botërore, duke e cilësuar si një hap të rëndësishëm për të përballuar fazën e katërt të ekonomisë, bazuar në dije. Znj. Ahmetaj vuri në dukje se trajnimet e parashikuara, veçanërisht në fushën e arsimit profesional, dhe përfshirja e digjitalizimit janë hapat drejt përmbushjes së këtyre objektivave. Ajo gjithashtu u shpreh mbi përmirësimet e nevojshme në tregun real dhe atë financiar, duke përmendur iniciativat e Bankës së Shqipërisë (BSH) për rritjen e efikasitetit në infrastrukturën financiare brenda dhe jashtë vendit. Znj. Ahmetaj theksoi rëndësinë e hyrjes në tregun e pagesave në Euro (SEPA) dhe përparimet në këtë drejtim për të përmirësuar transfertat financiare dhe zvogëluar kostot e tyre. Ajo shprehu përkushtimin e BSH për plotësimin e kushteve për hyrjen në SEPA, duke parë këtë si një hap drejt integritetit në BE.

Z. Neritan Mullaj, Dhoma Amerikane e Tregtisë, shprehu vlerësimin e tij për këtë mbledhje, veçanërisht në kontekst të konsultimeve për ERP. Ai e vlerësoi rolin e biznesit në këtë proces dhe theksoi se përfshirja e tij duhet të jetë e vazhdueshme. Z. Mullaj garantoj përfshirjen maksimale të biznesit në konsultimet për hartimin e dokumentit. Ai përmendi një problematikë të rëndësishme, mungesën e fuqisë punëtore, e cila është identifikuar edhe në indeksin e biznesit të prezantuar disa

ditë më parë nga Dhoma Amerikane. Z. Mullaj vlerësoi përpjekjet për adresimin e kësaj çështjeje në dokument dhe premtoi kontributin e Dhomës në këtë drejtim.

Në lidhje me kuadrin fiskal, z. Mullaj vlerësoi përmirësimin në komunikimin me administratën tatimore dhe doganore, por theksoi rëndësinë e qëndrueshmërisë fiskale për biznesin dhe investitorët potencialë. Z. Mullaj theksoi nevojën për përfshirjen e biznesit në hartimin e strategjisë afat-mesme të të ardhurave, duke e parë si një element të rëndësishëm në dialogun me FMN. Në lidhje me ERP, ai njoftoi se AmCham do të dërgojë komentet e saj brenda afatit të kërkuar.

**Ministri Ervin Mete, MFE**, falenderoi dhe vlerësoi kontributin e Dhomës Amerikane. Ministri nënvizoi se Plan i Rritjes dhe reformat janë ende në fazat e diskutimit dhe se ka një vullnet për ndryshim, përfshirë edhe MSA (Marrëveshjen Stabilizuese dhe Asociative), dokumentin më të rëndësishëm në marrëdhëniet me BE. Qëllimi është të përshpejtohet integrimi i sektorëve të caktuar ekonomikë me tregun e BE.

Ministri theksoi momentumin pozitiv dhe mundësitë që ofron dialogu i hapur dhe qasja konstruktive për të arritur përparime domethënëse. Për këtë arsye, Ministri u shpreh se temën e mbledhjes aktuale e propozoi ai si temë “jashtë rradhe”. Për axhendën e ardhshme të KI, Ministri Mete propozoi për diskutim temën e strategjisë afatmesme të të ardhurave, duke shpresuar se kjo strategji do të çojë në përmirësime të mëtejshme në fushën e digjitalizimit, përshpejtimin e ndërveprimit, procedurave, si dhe një interpretim të unifikuar të legjislacionit. Këto hapa presin të sjellin përmirësime në mënyrën se si administrata fiskale funksionon dhe si bizneset përballojnë sfidat fiskale.

**Znj. Evis Sulko, Banka Botërore**, falenderoi për mbledhjen dhe shprehu vlerësimin për punën KI dhe mbështetjen e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Si përfaqësuese e grupit të Bankës Botërore (BB) me kontributin e Korporatës Ndërkombëtare të Financës (IFC), ajo theksoi sinergjinë mes ERP dhe strategjisë së BB, e cila u miratua para gjashtë muajsh. Prioritetet janë të përputhura, duke siguruar që fushat për t'u ndjekur dhe ato që financohen nga BB janë në një përputhje të plotë.

Znj. Sulko theksoi se Gjithëpërfshirja e Planit të Rritjes dhe reformat janë në diskutim dhe mbështeten në disa dimensione, duke përfshirë jo vetëm aspektet makroekonomike dhe fiskale, por edhe qëndrueshmërinë. Ajo shtoi se do të ketë nevojë për një bashkëpunim të mirë mes MFE, BB, BE dhe donatorëve të tjerë për të përcaktuar prioritetet dhe për financimet që do vijnë nga secili prej donatorëve. Znj. Sulko shprehu interesin për të kuptuar koston e strategjisë dhe se sa do të nevojiten për financim, përfshirë dhe opsionet e grantit apo kredisë.

Ekipi i BB aktualisht po planifikon disa iniciativa lidhur me tregtinë dhe aksesin në financë. Ata po përgatisin një listë me aktivitete që mund të thellohen në diskutime ose tryeza më të ngushta. Znj. Sulko vlerësoi faktin që Ministri theksoi se këto reforma bëhen jo vetëm për procesin e integritimit, por gjithashtu për zhvillimin e përgjithshëm të vendit.

**Ministri Ervin Mete, MFE**, theksoi rolin e rëndësishëm të BB si një bashkëthemeluese kryesore në nismat për zhvillim. Ai përmendi se Planifikimi i Rritjes së Përbashkët (GPL), në të cilin u bë referencë, ka një dimension të katërt, atë të qëndrueshmërisë mjedisore, pra është i plotë. Në lidhje me kostot dhe financimin, Ministri identifikoi tri pika kryesore: konkurrueshmëria, rritja ekonomike dhe buxheti, duke theksuar se pa buxhet nuk mund të realizohen projektet. Në aspektin e financimit, Ministri theksoi se qeveria mbështeten në dy drejtime kryesore: buxhetimin e brendshëm dhe financimin e huaj nga BE/donatorët, duke përfshirë kredi të buta apo grante dhe ndihma. Ai njoftoi se do të ketë një koordinim të donatorëve pasi të përcaktohet një kostim, duke theksuar se struktura e koordinimit do të jetë e dobishme për të gjithë.

**Znj. Ines Muçostepa, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë (UCCIAL)**, falenderoi për organizimin e mbledhjes mbi këtë temë të rëndësishme. Ajo informoi se UCCIAL ka zhvilluar një ngjarje rajonale me mbështetjen e DG Near mbi Planin e Rritjes, me pjesëmarrjen aktive të bizneseve që dëshirojnë të kuptojnë avantazhet e tyre konkrete. Znj. Muçostepa vlerësoi fjalën e Ministrit, duke u shprehur se implementimi i reformave është në interesin e përbashkët.

Po ashtu, ajo raportoi mbi iniciativat në lidhje me Planin e Rritjes, duke theksuar bashkëpunimin e vazhdueshëm me 6 dhomat e tregtisë në rajon. Këto dhoma kanë një rol kyç në lirinë e tregut dhe në procesin e përshtetimit të integritimit. Prioritetet që u prezantuan në këtë mbledhje janë në përputhje me këto iniciativa.

Znj. Muçostepa përmendi se UCCIAL ka marrë një rol më të madh në samitin e dhomave të tregtisë dhe industrisë në rajon, përmes një mandati formal nga BE. Kjo do të mundësojë bashkëpunimin me CEFTA dhe RCC për të ndërtuar Tregun e Përbashkët Rajonal dhe për të përmirësuar integritimin mes vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ajo ftoi të gjithë aktorët në tryezë të kontribuojnë duke përcaktuar pikat që konsiderojnë më kryesore për ndërtimin e një strategjie të përbashkët.

**Ministri Ervin Mete, MFE**, sqaroi se pika e dytë e Planit të Rritjes përfshin krijimin e Tregut të Përbashkët Rajonal, i cili më pas do të integrohet me Bashkimin Evropian. Ai theksoi se bizneset luajnë një rol kyç në këtë proces dhe MFE do të jetë një partner i mirë në këtë drejtim.

**Znj. Ekaterina Solovova, BERZH**, shprehu mbështetjen e saj për procesin e vazhdueshëm konsultativ, duke theksuar rëndësinë e pasqyrimin të komenteve nga të gjitha palët e interesuara; konkretisht në fushat ku aktorë specifikë (përfshirë institucionet ndërkombëtare financiare) janë të angazhuar aktivisht me Qeverinë. Për BERZH-in fusha të tilla si energjia e rinovueshme dhe zhvillimi i infrastrukturës kanë interes të veçantë. Ndërsa u shpreh se dokumenti është gjithëpërfshirës, znj. Solovova ngriti disa komente specifike. Së pari, vërehet se dokumenti ka një shtrirje shumë të gjerë në disa pjesë (si p.sh. në zhvillimin e energjisë së rinovueshme, ku BERZH ka kontribuar në përcaktimin e standardeve të reformës për Planin e Rritjes), ndërkohë që disa masa, si rehabilitimi i rrjetit hekurudhor, duket se janë të kufizuara vetëm në një projekt, duke anashkaluar, për shembull, rëndësinë e zhvillimit të kapaciteteve të Hekurudhës Shqiptare ose masa të tjera reformuese që mundësojnë funksionimin e infrastrukturës së ndërtuar.

Më tej, znj. Solovova theksoi rolin kritik të kapaciteteve zbatuese të institucioneve relevante qeveritare dhe ndërmarrjeve shtetërore kur është fjala për realizimin e masave specifike, veçanërisht në kuadër të këtij programi trevjeçar. Ajo theksoi rëndësinë e marrjes në konsideratë të kapacitetit për zbatimin e iniciativave veçanërisht të mëdha të infrastrukturës, duke iu përmbajtur standardeve ndërkombëtare dhe të BE-së. Vonesat në zbatimin e projektit shpesh lindin për shkak të përputhshmërisë me standardet e BE-së në lidhje me ndikimet mjedisore dhe sociale, prokurimin dhe më shumë. Për të adresuar këtë, për shembull, në sektorin hekurudhor, BERZH dhe BEI kanë mobilizuar një paketë gjithëpërfshirëse të asistencës teknike për Hekurudhën Shqiptare, për të rritur kapacitetin për të zbatuar jo vetëm projektin e hekurudhës Tiranë-Durrës në vazhdim, por edhe për të gjitha projektet e mëvonshme, duke përfshirë një *master plan* operacional dhe mbështetje për kontratën e shërbimit publik. Në këtë kontekst, znj. Solovova theksoi rëndësinë e aksesit në asistencë teknike sa më shpejt që të jetë e mundur. Qasja në kohë në një ndihmë të tillë, si pjesë integrale e projektit, rrit mundësinë e zbatimit të tij brenda kuadrit kohor të caktuar.

**Znj. Laura Qorlaze, IFC**, komentoi disa nga sfidat kryesore që bizneset shqiptare hasin në lidhje me shtyllat e prioritizuara në ERP:

1. **Informaliteti dhe Kapacitetet e Administratës Fiskale**: Znj. Qorlaze vuri në dukje rëndësinë e trajtimit të informalitetit si prioritet në ERP, duke shtuar se një pjesë e rëndësishme e këtij problemi është lidhur me kapacitetet e administratës fiskale dhe nevojën për një reformë efektive në këtë

drejtim. Kontrolli i bazuar në rrezik duhet të shoqërohet me zbatim të duhur për të siguruar një ndryshim të vërtetë.

2. **Edukimi Profesional:** Edhe pse ERP përfshin masat për edukim profesional, znj. Qorlaze u shpreh se është e rëndësishme të rishikohet gjithë sistemi, duke pasur parasysh tendencat e emigracionit dhe nevojën për staf të kualifikuar në vend. Kjo nënkupton se mund të duhet një përmirësim i thelluar i sistemit arsimor dhe trajnimit profesional.
3. **Reforma e Pronësisë së Tokës:** Reforma në pronësi të tokës, iniciuar më herët, vazhdon të jetë një pengesë për investimet në sektorë kyç si bujqësia, turizmi, dhe energjia. Masa për të rregulluar këtë situatë duhet të merren sa më shpejtë për të lehtësuar zhvillimin në këto fusha.

**Znj. Elisabeta Katiaj, Dhoma e Biznesit të Diasporës,** u shpreh se pajtohet me zinxhirin e aktiviteteve dhe indikatorët për matjen e tyre. Znj. Katiaj shprehu vlerësimin për ERP si dokument dhe sugjeroi përfshirjen e diasporës për shkak të impaktit të saj si kapital human dhe potencialit për investitorë. Në lidhje me konkurrueshmërinë, sugjeroi një kombinim dhe bashkërendim midis koncepteve “*Made in Albania*” dhe “*Made by Albanians*”. Kjo, sipas saj, do të nxisë konsumatorët e diasporës të konsumojnë produkte vendase dhe do të promovojë vendin, përthithjen e trurit dhe interesat e partneritetit me sektorin privat.

Për çështjen e “*skilling*” (përmirësimi të aftësive), ajo vlerëson se ka ardhur një moment për një politikë të veçantë për “*re-skilling*” për sektorët në krizë, duke propozuar një strategji të mirëfilltë në bashkëpunim lokal me bashkitë për rritjen e cilësisë së fuqisë punëtore.

Në lidhje me sektorin privat, znj. Katiaj vlerësoi se ky sektor nuk mund të përballet vetëm me përmirësimin, automatizimin, dhe standardizimin dhe digjitalizimin për të konkurruar në tregjet ndërkombëtare. Ajo propozoi që planet për Shqipërinë Inteligjente dhe Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës të përfshijnë edhe sektorin privat, duke mbështetur NVM-të për të krijuar inovacion dhe për të përballuar sfidat ndërkombëtare.

**Z. Bledar Shella, Shoqata e Bankave,** përgëzoi cilësinë e dokumentit të përgatitur dhe vlerësoi përfshirjen e bankave në financimin e gjerë, me një theks të veçantë në digjitalizim dhe rritjen e produkteve të digjitalizuara, siç u përmend nga BSH. Ai theksoi se bankat duhet të kenë një rol kyç në përmirësimin e sistemit të pagesave. Shella vlerësoi fokusin tek financimi i projekteve në fushën e energjisë së rinovueshme dhe infrastrukturës, duke e konsideruar aspektin “*green*” si një pjesë të rëndësishme të strategjisë për vitet në vijim.

Në lidhje me informalitetin, ai u shpreh që, pavarësisht aksioneve të ndërmarrë, niveli i lartë i informalitetit mbetet një faktor pengues për ekonominë dhe për financimin nga bankat.

Për sektorin e edukimit, z. Shella u shpreh se fokusi tek shkollat profesionale është i rëndësishëm, por theksoi nevojën për një reformë themelore në sistemin edukativ, duke përmendur degradimin dhe problematikat aktuale. Ai shprehu shqetësimin se degradimi i sistemit arsimor është një nga arsyt kryesore që njerëzit largohen, dhe propozoi që kjo të konsiderohet si një reformë që do të sjellë rezultate afatgjata, duke filluar tani për të kontribuar në afatmesëm dhe afatgjatë.

**Z. Agim Rrapaj, KASH,** ngriti disa komente dhe shqetësime lidhur me programin ERP:

1. **Disbursimi i Fondeve:** Fokusi kryesor është tek buxhetimi dhe disbursimi i fondeve nga BE dhe buxheti i shtetit. Procesi i disbursimit mund të zgjasë, dhe për këtë arsye është e rëndësishme që ky proces të mos vonohet, pra një sfidë kohore që duhet adresuar menjëherë.
2. **Politikat Sociale në Zonat Rurale:** Grupmosha mbi 60 vjeç të konsiderohet si një pjesë e politikave sociale në zonat rurale. Pra një pikë e rëndësishme për t’i kushtuar vëmendje nevojave të kësaj grupmoshe.
3. **Platforma Digjitale dhe NVM-të:** Z. Rrapaj përmendi mbështetjen e BE për platformën dixhitale të FED Invest dhe rëndësinë e platformës për portalin e fermerit mbështetur nga BERZH.



Lidhja e këtyre platformave mund të sjellë rezultate të mira në mbështetjen e fermerëve dhe zhvillimin e sektorit bujqësor.

4. Ligji për NVM-të në Bujqësi: Nevojitet një ligj i veçantë për bujqësinë, pasi ligji aktual, Ligji për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor, është jashtë kohe dhe pengon zhvillimin e NVM-ve në bujqësi.
5. Informaliteti dhe TVSH-ja në Bujqësi: Një nga problemet kryesore në bujqësi mbetet TVSH-ja dhe duhet të merren masa për zgjidhjen e kësaj çështjeje, duke pasur parasysh diskutimet që janë nisur në nivel teknik.

**Ministri Ervin Mete, MFE**, njoftoi se ka ndryshuar udhëzimi për njohjen e kostove të TVSH-së për sektorët e prodhimit bujqësor, përfshirë sektorët e qumështit dhe blegtorisë, nga 2% në 12%. Ky ndryshim synon të reflektojë më mirë realitetin e kostove të prodhimit në këto sektorë dhe të krijojë një nivel krahasimi më të drejtë me industri të tjera. Z. Mete theksoi se Shqipëria është e gatshme të diskutojë ndërhyrje të mëtejshme që do të lehtësojnë ndërlidhjet me tregjet rajonale dhe evropiane. Ai citoi parashikimet e BB për rritjen ekonomike të Shqipërisë, ku një nga sfidat është ndërlidhja më e mirë me tregun evropian. Në këtë kontekst, z. Mete ftoi për sugjerime dhe bashkëpunim organizatat dhe dhomat e tregtisë, me qëllim të përmirësimit të ndërlidhjeve dhe shkëmbimeve tregtare, pasi afërsia me tregun evropian ka qenë një faktor pozitiv për rritjen e ekonomisë shqiptare.

**Z. Artan Xhiani, Confindustria Albania**, shprehu shqetësimin për disa problematika të cilat janë ngritur gjatë vitit në KI dhe për të cilat nuk është marrë informacion mbi ecurinë e zgjidhjes së tyre. Është e domosdoshme që këto çështje të merren seriozisht nga KI.

1. Platforma e fiskalizimit. Nuk ka nevojë për ndryshime të akteve ligjore dhe nënligjore por për mundësimin teknik të atyre shërbimeve që kuadri aktual i njej.
2. Shërbimet online. Një pjesë e shërbimeve online janë pamundësuar. Në kushtet kur mungojnë dhe sportelet fizike, krijohen sorollatje, dhe bizneset nuk dinë ku të paraqiten dhe shpesh marrin me shumë vonesë këto lloj shërbimesh.
3. Në lidhje me diskutimin e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Ardhurave, z. Xhiani shprehu vlerësimin për këtë iniciativë duke shpresuar se do të ndihmojë në prognozën e zhvillimit të biznesit në të ardhmen. Ndërkohë, paqëndrueshmëria fiskale mbetet një problem madhor, duke kushtëzuar planet e investimit të biznesit dhe investitorëve.
4. Në lidhje me reformën në fushën e edukimit profesional, z. Xhiani përmendi raportin e PISA-s dhe gjetjet e tij si një shqetësim. Ai theksoi nevojën që gjetjet dhe analizat në fushën e arsimit të jenë në vëmendjen e institucioneve arsimore dhe atyre që janë të përfshirë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe rajonit.

**Z. Loritan Prespa, Dhoma e Tregtisë Tiranë**, informoi mbi kapacitetet e Dhomës së Tregtisë Tiranë në zbatimin e projekteteve të ndryshme ndërkombëtare në Shqipëri, dhe gatishmërinë për të qenë një partner zbatues në projektet e ardhshme të synuara.

### Mbyllja e mbledhjes

**Ministri Ervin Mete, MFE**, informoi se mbledhja mbi Strategjinë Afatmesme dhe pjesën fiskale më gjerë (fiskalizimi, TVSH, kontrollet, informaliteti, etj.) është një nga temat e afërta që duhet të trajtohet në KI duke konsideruar edhe rekomandimet e dhëna më parë dhe ato që janë marrë parasysh. Partneriteti dhe komunikimi i ndërsjelltë është i nevojshëm për arritjen e dakordësisë, ecurisë dhe efektivitetit të reformave të tilla.

Në përfundimin të të gjitha komenteve, Ministri Mete falenderoi pjesëmarrësit për kontributin dhe e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

## Lista e pjesëmarrjes

### Përfaqësues të qeverisë

1. Z. Ervin Mete, Kryetar i Këshillit të Investimeve/Ministër i Financave dhe Ekonomisë
2. Znj. Natasha Ahmetaj, Zëvendës Guvernatore e Bankës së Shqipërisë
3. Znj. Laura Plaku, CEO, AIDA

### Përfaqësues të biznesit

1. Z. Loritan Prespa, Nënkryetar, deleguar nga z. Nikolin Jaka, Kryetar, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë
2. Znj. Ines Muçostepa, Kryetare, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë
3. Znj. Antonela Hako, Kryetare, Dhoma Ekonomike e Gruas (DHEG)
4. Z. Tomi Beruka, Kryetar Bordi, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë
5. Z. Neritan Mullaj, CEO, AmCham Albania, deleguar nga z. Grant Van Cleve, President
6. Znj. Elisabeta Katiaj, Nënkryetare, deleguar nga z. Ardian Lekaj, Kryetar, Dhoma Shqiptare e Biznesit të Diasporës
7. Z. Agim Rrapaj, Kryetar, KASH (*ad-hoc*)
8. Z. Bledar Shella, Kryetar i Bordit Mbikëqyrës, Shoqata Shqiptare e Bankave (*ad-hoc*)

### Partnerë ndërkombëtarë

1. Z. Hubert Perr, Shef i Bashkëpunimit, Delegacioni i BE-së
2. Znj. Ekaterina Solovova, Drejtore e Zyrës së BERZH-it në Shqipëri
3. Znj. Evis Sulko, Drejtoreshë e Komanduar e Bankës Botërore për Shqipërinë
4. Znj. Laura Qorlaze, Përfaqësuese, IFC

### Nuk morën pjesë:

1. Znj. Delina Ibrahimaj, Ministër Shteti për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit
2. Z. Bilal Kara, Kryetar, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri – Turqi (ATTSO)

### Të ftuar të veçantë:

1. Z. Endrit Yzeiraj, Zv/Ministër i Financave dhe Ekonomisë

### Të ftuar të tjerë:

#### Ish anëtarë të biznesit në KI

2. Z. Artan Xhiani, Anëtar Bordi/Ekspert, Confindustria Albania
3. Znj. Gerta Bilali, Drejtore Ekzekutive, Confindustria Albania
4. Z. Bledar Mankollari, Drejtor Ekzekutiv, Dhoma Gjermane e Tregtisë (DIHA)

#### Përfaqësues të tjerë

5. Z. Aleko Polo, Drejtor Ekzekutiv, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë
6. Z. Erion Harizi, Kryetar i Bordit Drejtues, Shoqata e Ndërtuesve
7. Znj. Albana Laknori, Sekretare e Përgjithshme, Dhoma e Tregtisë Tiranë
8. Z. Artan Luku, Kryetar, Dhoma e Tregtisë Durrës
9. Znj. Klodiana Ajazi, CEO, Dhoma Ekonomike e Gruas
10. Znj. Ardita Seknaj, Sekretare e Përgjithshme, ICC Albania

11. Z. Denald Tafani, Kryetar, Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri
12. Znj. Erifili Berberi, Drejtore Ekzekutive, Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri
13. Znj. Adelinda Farriçi, Sekretare e Përgjithshme, Shoqata per Autonomi Vendore
14. Z. Reinaldo Pipiria, Kryetar, Shoqata e Pasurive të Patundshme
15. Znj. Marlinda Zotaj, Head of Office, Advantage Austria
16. Znj. Tiziana Domi, Koordinatore Projekti, SWISSA
17. Shoqata “Bashkimi Tregtar i Shqipërisë”
18. Znj. Eralda Shtylla, Shefe Sektori, MFE
19. Z. Elson Caka, Specialist, MFE
20. Znj. Natasha Rovo, Ekonomiste e Lartë, Banka Botërore
21. Znj. Hilda Shijako, Ekonomiste e Lartë, Banka Botërore
22. Z. Keler Gjika, Ekspert Fiskal, Banka Botërore
23. Znj. Sigita Stafa, Manaxhere Programi, Ambasada e Zvicerës në Shqipëri
24. Znj. Ledia Muço, Këshilltare për Çështjet Ekonomike, Delegacioni i BE-së
25. Znj. Endrita Xhaferaj, Këshilltare e Lartë, BERZH